



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 750, datë 27.11.2019

PËR

SHPALLJEN E GJENDJES SË FATKEQËSISË NATYRORE
NË QARQET DURRËS DHE TIRANË

Në mbështetje të neneve 100, 170 e 174 të Kushtetutës, dhe të neneve 18, shkronja “ç”, 19 e 39, të ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë, si pasojë e dëmeve të shkaktuara nga tërmeti i datës 26.11.2019, për një periudhë jo më të gjatë se 30 (tridhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
2. Krijimin e Komitetit Ndërmintor të Emergjencave Civile (KNEC), si organi më i lartë për koordinimin dhe bashkërendimin e veprimeve të institucioneve shtetërore dhe të subjekteve private, si dhe të burimeve financiare e materiale për përballimin e fatkeqësisë natyrore.
3. KNEC-ja kryesohet nga Kryeministri dhe ka në përbërje anëtarët, si më poshtë vijon:
 - Ministrin e Mbrojtjes;
 - Ministrin e Brendshëm;
 - Ministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
 - Ministrin e Financave dhe Ekonomisë;
 - Ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë;

- Ministrin e Turizmit dhe Mjedisit;
 - Ministrin e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
 - Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile;
 - Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura;
 - Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit;
 - Prefektin e Qarkut Durrës;
 - Prefektin e Qarkut Tiranë.
4. Në mbledhjet KNEC-së marrin pjesë me kërkesë të Kryetarit përfaqësues të organeve të ndryshme publike, të biznesit, ekspertë/profesionistë të fushës së mbrojtjes civile dhe përfaqësues të shoqërisë civile ose drejtues të OJF-ve, me objekt veprimtarie mbrojtjen civile dhe ndihmën humanitare.
 5. Mbledhjet e KNEC-së, në mungesë të Kryetarit, me autorizim të tij, drejtohen nga një funksionar i lartë shtetëror.
 6. Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile kryen funksionin e Sekretariatit Teknik të KNEC-së.
 7. Për përballimin dhe lehtësimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë merren masat e jashtëzakonshme, si më poshtë:

7.1. Institucionet publike:

- a) të realizojnë plane masash organizative dhe administrative për përballimin e gjendjes së fatkeqësisë natyrore;
- b) të përdorin burimet financiare të parashikuara në buxhetin vjetor, si dhe të rivlerësojnë buxhetin e tyre vjetor, në përputhje me kryerjen e shpenzimeve shtesë të parashikuara;
- c) të vënë në dispozicion burimet njerëzore dhe logjistike;
- ç) të caktojnë objektet shtetërore në përgjegjësinë e tyre të administrimit, që mund të vihen në dispozicion për strehimin e popullsisë së evakuuar;
- d) të marrin masa të tjera që ndihmojnë në përballimin dhe lehtësimin e pasojave të fatkeqësisë;
- dh) përjashtimisht, procedurat e prokurimit për mbulimin e nevojave emergjente, si rezultat i dëmeve të shkaktuara nga tërmeti i datës 26 nëntor t'i zhvillojnë në rrugë shkresore;
- e) ministritë të ngrenë grupe pune, për koordinimin e ndihmave me strukturat e mbrojtjes civile.

7.2. Strukturat operacionale të sistemit të mbrojtjes civile:

- a) të vendosin dhe të zbatojnë masa të veçanta për garantimin dhe rritjen e sigurisë së shtetasve në zonat e prekura nga fatkeqësia;
- b) të aktivizojnë dhe të organizojnë procedura të evakuimit për popullsinë e rrezikuar;
- c) të organizojnë kontrole të njëanëshme ose në bashkëpunim me komunitetin të banesave dhe objekteve private për gjetjen e të mbijetuarve dhe të viktimave të fatkeqësisë, si dhe procedurat e detyruara për kryerjen e shërbimeve funerale.

7.3. Subjektet private”

- a) të respektojnë procedurat dhe masat për evakuimin dhe strehimin e të evakuuarve;
- b) të informojnë lidhur me të dhënat që ndihmojnë institucionet dhe strukturat e mbrojtjes civile në përballimin e gjendjes së fatkeqësisë;
- c) të përfshihen në detyra të veçanta, në përputhje me përgatitjen, aftësitë dhe me nevojën për të ndihmuar në kapërcimin e gjendjes së fatkeqësisë natyrore;
- ç) të mbyllin përkohësisht veprimtaritë e tyre, si dhe të kryejnë shërbime të ndryshme në funksion të përballimit të fatkeqësive, apo dhe të prodhojnë artikuj të emergjencës, për të cilat do të kompensohen nga buxheti i shtetit sipas marrëveshjeve;
- d) të mos vjelin tarifatat e kalimit rrugor për mjetet e angazhuara në përballimin e gjendjes së fatkeqësisë natyrore.

7.4. Shtetasit:

- a) të zbatojnë urdhrat, masat dhe udhëzimet e autoriteteve të mbrojtjes civile, si dhe të ndjekin procedurat e kërkuara, në mënyrë të veçantë për evakuimin;
- b) të informojnë lidhur me të dhënat që ndihmojnë institucionet publike dhe strukturat e mbrojtjes civile në përballimin e gjendjes së fatkeqësisë;
- c) të përfshihen në detyra të veçanta, në përputhje me përgatitjen, aftësitë dhe me nevojën për të ndihmuar në kapërcimin e gjendjes së fatkeqësisë natyrore.

8. Për procedurat, afatet dhe strukturat shtetërore përgjegjëse për vlerësimin e dëmeve do të zbatohen rregullat e përcaktuara në vendimin nr.329, datë 16.5.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”.

9. Kompensimi i subjekteve për pasuritë e dëmtuara nga tërmeti do të bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.

10. Ngarkohen ministrinë dhe institucionet e përmendura në pikën 3 për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDIRAMA

MINISTRI I MBROJTJES

OLTA XHAÇKA



